



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 18 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi datën e fillimit të gjykimit dhe pika të tjera që lidhen me të

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (“Trupi Gjykues”) merr vendimin e mëposhtëm mbi datën e fillimit të gjykitimit dhe çështje të tjera të lidhura.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 shkurt 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi dosjen paraprake, listën e dëshmitarëve (“lista e dëshmitarëve”), dhe listën e provave materiale, (“lista e provave”), në përputhje me rregullën 95(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).¹
2. Më 7 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake² ia kaloi Trupit Gjykues dosjen e çështjes, në përputhje me rregullën 98 të Rregullores.³
3. Më 20 maj 2021, Trupi Gjykues lëshoi “Vendim për caktimin e datave për mbajtjen e konferencave përgatitore për gjykimin dhe për parashtrime nga palët” (“vendimi”), me të cilin vendosi që konferencat përgatitore për gjykimin, që do të zhvillohen në seanca publike dhe të mbyllura, të mbahen më 9, 10 dhe 11 qershor 2021, sipas nevojës, dhe i kërkoi ZPS-së, Mbrojtjes së Salih Mustafës (“z. Mustafa” ose “i akuzuari”), mbrojtëses së viktimave, dhe Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve

¹ KSC-BC-2020-05, F00082, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i dosjes paraprake me listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale*, 15 shkurt 2021, publik, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e redaktuara konfidenciale të listës së dëshmitarëve të ZPS-së dhe listës së provave materiale të ZPS-së u protokolluan më 17 shkurt 2021, F00085/A02 dhe F00085/A03. Versioni i korrigjuar i dosjes paraprake u protokollua më 23 shkurt 2021, si version rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00088/A01) dhe version i redaktuar konfidencial (F00088/A02).

² KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-05, F00119, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues I*, 7 maj 2021, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale.

(“ZMMD”) të Zyrës Administrative që të paraqisnin parashtrimet e tyre në lidhje me disa pika.⁴

4. Më 2 qershor 2021, ZPS-ja,⁵ Mbrojtja,⁶ mbrojtësja e viktimave⁷ dhe ZMMD-ja⁸ dorëzuan parashtrimet e tyre përkatëse.

5. Më 9 qershor 2021, Trupi Gjykses mbajti konferencën e parë përgatitore për gjykimin, në seancë publike, në të cilën palët, mbrojtësja e viktimave dhe Zyra Administrative paraqitën parashtrimet e tyre në lidhje me pikat e renditura në vendimin.⁹ Më 9 dhe 10 qershor 2021 u mbajtën edhe dy konferenca përgatitore të tjera për gjykimin, në seancë *ex parte* dhe të mbyllur, në të cilat, njësi të Zyrës Administrative dhe ZPS-ja paraqitën parashtrimet e tyre në lidhje me pikat e renditura në vendimin dhe shtojcat e tij.¹⁰

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të nenit 40(2) dhe (6) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 116(1) të Rregullores, Trupi Gjykses merr vazhdimisht të gjitha masat dhe miraton procedurat e nevojshme

⁴ KSC-BC-2020-05, F00123, Trupi Gjykses I, *Vendim për caktimin e datave për mbajtjen e konferencave përgatitore për gjykimin dhe për parashtrime nga palët*, 20 maj 2021, publik, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00130, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në përputhje me KSC-BC-2020-05/F00123* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 2 qershor 2021, publike, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00128, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me përgatitjet për gjykimin* (“Parashtrimet e Mbrojtjes”), 2 qershor 2021, publik.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00129, Mbrojtësja e viktimave, *Parashtrim për konferencën përgatitore për gjykimin* (“Parashtrimet e viktimave”), 2 qershor 2021, publike.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00131, Administratorja, *Parashtrimet e Zyrës Administrative për konferencat përgatitore për gjykimin*, 2 qershor 2021, publike, me shtojcën 1, konfidenciale, dhe shtojcën 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës (Transkripti publik i 9 qershorit 2021), 9 qershor 2021, publik.

¹⁰ Transkript i seancës, 9 qershor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Transkript i seancës, 10 qershor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit. Këtu mund të përfshihen, ndër të tjera, përcaktimi i afatit për çfarëdo mocioni që do të dorëzohet para hapjes së çështjes sipas rregullës 117(2) të Rregullores; caktimi i datës për hapjen e çështjes, në përputhje me rregullat 118(3), 124, dhe 125 të Rregullores; dhe përcaktimi i kohës dhe modaliteteve të deklaratave hyrëse, në përputhje me rregullën 126 të Rregullores.

III. ANALIZË

A. FAKTET E SHQYRTUARA NË PROCESE TË TJERA

7. Megjithëse parashtrimi i një kërkesë sipas rregullës 157(2) të Rregullores nuk supozon që midis palëve në proces është arritur marrëveshje, sikurse vëren me të drejtë ZPS-ja,¹¹ Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja duket se është e gatshme të këshillohet me ZPS-në në lidhje me këtë pikë, në mënyrë që në fund të arrihet marrëveshje.¹² Palët janë shprehur se këto këshillime kanë ndërmend t'i kryejnë këtë muaj dhe se pavarësisht nëse arrijnë marrëveshje ose jo, mocionin ose mocionet e tyre sipas rregullës 157(2) të Rregullores do t'i dorëzojnë deri në fund të qershorit 2021.¹³

8. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në dhe Mbrojtjen që deri të mërkurën, 30 qershor 2021, të dorëzojnë parashtrim të përbashkët dhe/ose veç e veç, ku t'i kërkojnë Trupit Gjykses që të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera. Përgjigjet, nëse do të ketë, mund të parashtrohen brenda afatit të përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores.

¹¹ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 239, rreshti 24 deri në f. 240, rreshti 6.

¹² Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 240, rreshtat 9-11 dhe f. 241, rreshtat 21-22.

¹³ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 241, rreshtat 7-8 dhe f. 242, rreshtat 1-4.

B. KËRKESAT E ZPS-SË NË LIDHJE ME PROVA SHITESË

1. Parashtrimet

9. ZPS-ja parashtron se ka ndërmend që në gjysmën e dytë të qershorit 2021 t'i parashtojë Trupit Gjykses kërkesë për përfshirjen e disa materialeve në listën e saj të provave, përkatësisht disa të dhëna të nxjerra nga telefoni i të akuzuarit, transkriptet e dy intervistave plotësuese me dëshmitarët W01679 dhe W03593, dhe disa dokumente të tjera.¹⁴ Në lidhje me këtë, në rast se gjykimi do të fillojë pas pushimit veror të Gjykatës, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses që të autorizojë redaktimin e këtyre intervistave plotësuese, në përputhje me masat mbrojtëse të miratuara më parë.¹⁵ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se ka ndërmend të përfshijë edhe një dëshmitar në listën e vet të dëshmitarëve si rezultat i një interviste të bërë rishtazi me këtë person, dhe këtë kërkesë t'ia parashtojë Trupit Gjykses së bashku me kërkesën për përfshirjen e materialeve shtesë në listën e provave.¹⁶

2. Konstatime

10. Në interes të një gjykimi të shpejtë dhe për t'i dhënë Mbrojtjes mundësinë që këto prova shtesë të ZPS-së, në rast se autorizohet përfshirja e tyre, t'i marrë parasysh gjatë përgatitjeve për misionet hetimore, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që kërkesën për ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe të listës së provave sipas rregullës 118(2) të Rregullores, ta parashtojë më së voni deri të mërkurën, 30 qershor 2021. Trupi Gjykses pastaj do të marrë vendim mbi këtë kërkesë, si dhe mbi kërkesën e ZPS-së për masa mbrojtëse në lidhje me intervistat plotësuese të W01679 dhe W03593.

¹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5-6.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

¹⁶ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 211, rreshtat 2-8.

Përgjigjet, nëse do të ketë, mund të parashtrohen brenda afatit të përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores.

C. KËRKESA TË TJERA SIPAS RREGULLËS 117(2) TË RREGULLORES

11. Trupi Gjykses rikujton se në përputhje me rregullën 117(2) të Rregullores, Trupi Gjykses përcakton një afat për çfarëdo mocioni që do të dorëzohet para hapjes së çështjes. Këto mocione duhet të përfshijnë të gjitha pikat (që nuk janë përfshirë në paragrafët 7-10 më lart) zgjidhja e të cilave, sipas mendimit të palëve, është parakusht për fillimin e gjykimit. Rregulla 117(2) e Rregullores parashikon që Trupi Gjykses të këshillohet me palët përpara se të caktojë afatin për paraqitjen e atyre mocioneve, por nuk specifikon shprehimisht se kush mund të paraqesë mocione të tilla. Trupi Gjykses vlerëson se Mbrojtja dhe ZPS-ja gjithsesi mund të paraqesin mocione të tilla. Për sa i përket mbrojtëses së viktimave, Trupi Gjykses gjykon se, në përputhje me vendimin e 21 majit 2021,¹⁷ edhe ajo mund t'i parashtrojë Trupit Gjykses kërkesa që lidhen me interesat personale të viktimave, për të cilat duhet marrë vendim para fillimit të gjykimit.

12. Në përputhje me sa më lart, pasi ka shqyrtuar parashtrimet e palëve dhe mbrojtëses së viktimave lidhur me hapat e mbetur që duhen marrë në mënyrë që çështja të jetë e gatshme për gjykim, Trupi Gjykses e vlerëson të përshtatshme të caktojë të enjten, 15 korrik 2021, si afat të fundit për parashtrimin nga palët dhe mbrojtësja e viktimave, të çfarëdo kërkesë brenda kuptimit të rregullës 117(2) të Rregullores. Duke mbajtur parasysh pushimin veror të Gjykatës,¹⁸ Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme që, në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, të zgjasë

¹⁷ KSC-BC-2020-05, F00126/RED, Trupi Gjykses I, *Version i redaktuar publik i vendimit të tretë mbi pjesëmarrjen e viktimave*, 21 maj 2021, publik, para. 40.

¹⁸ Pushimi veror i Gjykatës fillon nga e hëna më 26 korrik 2021 deri të premten, më 13 gusht 2021, shih KSCPR-2020, Kryetarja, *Pushimet e Gjykatës për 2021*, 10 nëntor 2020, publik.

afatin për parashtrimin e përgjigjeve të paraparë në rregullën 76 të Rregullores. Rrjedhimisht, palët dhe mbrojtësja e viktimave mund t'i parashtrojnë përgjigjet e tyre ndaj kërkesave brenda kuptimit të rregullës 117(2) të Rregullores, më së voni deri të enjten, 19 gusht 2021.

D. FILLIMI I GJYKIMIT DHE DEKLARATAT HYRËSE

1. Parashtrimet

13. ZPS-ja parashtron se gjykimi duhet të fillojë më 12 korrik 2021 me hapjen e çështjes dhe informacionin fillestar për të akuzuarin sipas rregullave 124-125 të Rregullores, si dhe me deklaratat hyrëse në bazë të rregullës 126 të Rregullores, vijuar nga dëshmitë e dy dëshmitarëve të ZPS-së, që do të fillonin më 15 korrik 2021, ose rreth kësaj date, ose, si do që të jetë, para pushimit veror të Gjykatës.¹⁹ ZPS-ja më tej parashtron se ka ndërmend të bëjë deklaratë hyrëse në përputhje me rregullën 126(1) të Rregullores, gjatë së cilës do të përdorë materiale vizuale ndihmëse, dhe kërkon që për të t'i miratohen dy deri në tri orë.²⁰ ZPS-ja gjithashtu parashtron se nëse gjykimi do të fillojë në shtator 2021, dy dëshmitarët e parë të saj duhet të dëgjohen menjëherë pas deklaratave hyrëse.²¹

14. Mbrojtësja e viktimave parashtron se gjykimi duhet të fillojë pas pushimit veror të Gjykatës, përkatësisht pas mesit të gushtit 2021.²² Mbrojtësja e viktimave gjithashtu parashtron se ka ndërmend të bëjë deklaratë hyrëse, pa materiale vizuale ndihmëse, për të cilën do t'i duhen jo më shumë se një orë e gjysmë.²³ Në lidhje me këtë, mbrojtësja e viktimave thekson se nëse gjykimi do të fillonte në korrik 2021, asaj do t'i

¹⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13; Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 221, rreshtat 9-18.

²⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

²¹ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 221, rreshti 19 to f. 222, rreshti 1.

²² Parashtrimet e viktimave, para. 6.

²³ Parashtrimet e viktimave, para. 7.

duhej të shtynte deklaratën hyrëse për më vonë, duke marrë parasysh se ende nuk ka shkuar në mision për t'u takuar me klientët e saj, dhe se për një deklaratë hyrëse të mirëfilltë i duhet kohë për t'u përgatitur.²⁴ Mbrojtësja e viktimave më tej shton se përgatitja e një misioni të tillë kërkon "organizim mjaft të ndërlikuar", për shkak të masave mbrojtëse në fuqi.²⁵ Mbrojtësja e viktimave thekson se ka pasur diskutime "paraprake" me ZPS-në në lidhje me viktimat që kanë status të dyfishtë, përkatësisht si viktimat dhe dëshmitarë.²⁶ Në lidhje me këtë, ZPS-ja parashtron se do ta ndihmojë mbrojtësen e viktimave për t'i kontaktuar viktimat me status të dyfishtë, që janë njëkohësisht edhe dëshmitarë të ZPS-së. Megjithatë, deri më tani nuk janë organizuar takime të drejtpërdrejta, dhe në lidhje me këto kontakte duhen marrë parasysh disa aspekte të sigurisë.²⁷ Ndryshe, mbrojtësja e viktimave parashtron se parapëlqen të bëjë deklaratën hyrëse menjëherë pas ZPS-së.²⁸ Në fund, mbrojtësja e viktimave thekson se ende nuk e ka formuar ekipin e vet.²⁹

15. Mbrojtja parashtron se gjykimi duhet të fillojë rreth dy javë pas pushimit veror të Gjykatës, duke marrë parasysh logjistikën dhe përgatitjet e nevojshme për fillimin e procesit.³⁰ Në këtë kontekst, Mbrojtja thekson se ka planifikuar disa misione hetimore për në qershor, korrik (javën e dytë dhe të tretë të atij muaji) dhe fillim të gushtit 2021.³¹ Mbrojtja thekson se pas secilit nga këto misione hetimore do të bëjë nxjerrjen e materialeve shtesë.³² Mbrojtja gjithashtu argumenton se nuk do të ishte mirë që gjykimi të ndahej në dysh, ku njëra pjesë të zhvillohej para pushimit veror të Gjykatës,

²⁴ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 222, rreshtat 16-25, f. 223, rreshtat 1-14.

²⁵ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 222, rreshtat 16-20.

²⁶ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 229, rreshti 17-18.

²⁷ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 228, rreshti 20 deri në f. 229, rreshti 13.

²⁸ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 223, rreshtat 1-14.

²⁹ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 208, rreshtat 7-8.

³⁰ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 224, rreshtat 17-25.

³¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 13-15; Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 224, rreshtat 9-10; shih gjithashtu f. 215, rreshtat 1-8.

³² Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 215, rreshtat 8-11.

kurse tjetra pas tij.³³ Mbrojtja më tej parashtron se ka ndërmend të bëjë deklaratë hyrëse para fillimit të paraqitjes së provave të veta.³⁴ Gjatë deklaratës së vet hyrëse, Mbrojtja do të përdorë materiale vizuale dhe mjete të tjera ndihmëse; deklarata hyrëse parashikohet të zgjasë një ditë të tërë dhe mund të përfshijë edhe një deklaratë të të akuzuarit sipas rregullës 142(1) të Rregullores.³⁵

2. Konstatime

16. Duke u nisur nga parashtrimet e marra, Trupi Gjykses gjykon se duket qartë se deri me sot, ZPS-ja, Mbrojtja, dhe mbrojtësja e viktimave nuk janë të gatshëm për fillimin e gjykimit. Konkretisht, Trupi Gjykses rikujton se ZPS-ja ende duhet t'i parashtrijë Trupit Gjykses kërkesa për përfshirjen e disa materialeve në listën e provave dhe përfshirjen e një dëshmitari në listën e dëshmitarëve të ZPS-së. Transkriptimi i dy intervistave në gjuhën shqipe dhe atë anglishte është në kryerje e sipër.³⁶ Materiali i mbledhur rishtazi, nëse do të lejohet nga Trupi Gjykses në përputhje me rregullën 118(2) të Rregullores, mund të jetë i rëndësishëm për misionet hetimore që ka planifikuar Mbrojtja dhe për përgatitjen e saj për gjykim. Për më tepër, Mbrojtja ka planifikuar disa misione hetimore për javët në vijim me synimin e përfundimit të hetimeve të saj deri nga mesi i gushtit 2021, të cilat mund të rezultojnë në nxjerrjen e mëpasshme të provave të tjera.³⁷ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vlerëson se, nëse gjykimi do të fillojë para pushimit veror të Gjykatës, Mbrojtja nuk do të jetë në pozitë të përgatitet si duhet, sidomos për pyetjet për dëshmitarët e parë të ZPS-së. Gjithashtu, Trupi Gjykses mbështet synimin e shprehur të Mbrojtjes për

³³ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 224, rreshtat 15-15, f. 225, rreshtat 3-4.

³⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 17.

³⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 17-18; Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 223, rreshti 22 to f. 224, rreshti 2.

³⁶ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 211, rreshtat 16-18.

³⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2-3; Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 212, rreshti 22 deri në f. 214, rreshti 9, f. 214, rreshti 22 deri në f. 215, rreshti 14.

përfundimin e hetimeve të saj para fillimit të gjykimit, që do të kursejë kohë të konsiderueshme gjatë vetë gjykimit. Së fundi, Trupi Gjykses vlerëson se ende ekzistojnë pengesa të konsiderueshme logjistike dhe të sigurisë për mbrojtësen e viktimave kur është fjala për takimin e saj me viktimat që janë njëkohësisht edhe dëshmitarë të ZPS-së.³⁸ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vëren se, megjithëse ka kaluar më shumë se një muaj nga caktimi i mbrojtëses së viktimave,³⁹ diskutimet midis ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave për mundësimin e kontaktit të saj me viktimat që kanë status të dyfishtë, janë ende në fazë paraprake. Për mendimin e Trupit Gjykses, është e rëndësishë thelbësore që këto diskutime të shënojnë progres sa më shpejt, në mënyrë që mbrojtësja e viktimave të ketë mundësinë të përgatitet dhe të jetë në gjendje t'i përfaqësojë si duhet viktimat. Përveç kësaj, mbrojtësja e viktimave duhet të formojë ekipin e vet. Për këtë arsye, asaj i duhet kohë e mjaftueshme për t'u përgatitur për hapjen e gjykimit.

17. Në bazë të vlerësimit të vet lidhur me gatishmërinë e palëve dhe mbrojtëses së viktimave për fillimin e gjykimit, Trupi Gjykses është i mendimit se nuk është praktike që gjykimi të fillojë në një datë para pushimit veror të Gjykatës. Njëkohësisht, Trupi Gjykses gjykon se është me rëndësi, ndër të tjera edhe për arsye të sigurisë së dëshmitarëve, që të mos lihen boshllëqe të panevojshme midis dëshmitarëve të dëshmitarëve, përveç atyre që lidhen me logjistikën e sallës së gjyqit. Për këtë arsye, në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Trupi Gjykses vendos, së pari, të shtyjë afatin e përcaktuar në rregullën 118(3) të Rregullores, ku parashihet që data e hapjes së çështjes është zakonisht tridhjetë (30) ditë pas konferencës përgatitore për Prokurorin e Specializuar sipas rregullës 118 të Rregullores. Gjatë konferencave të përbashkëta përgatitore për gjykimin, Trupi Gjykses ka marrë të gjithë informacionin

³⁸ Transkripti publik i 9 qershorit 2021, f. 222, rreshtat 16-25; f. 228, rreshti 20 deri në f. 229, rreshti 20.

³⁹ KSC-BC-2020-05, F00117, Administratorja, *Njoftim për caktimin e mbrojtësit të viktimave Grupit 1 të viktimave pjesëmarrëse në proces*, 7 maj 2021, publik.

e nevojshëm të parashikuar në rregullën 118 të Rregullores. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vendos të caktojë të mërkurën, 15 shtator 2021, dhe të enjten, 16 shtator 2021 (si ditë rezervë),⁴⁰ si data të hapjes së çështjes për gjykim, ku do të përfshihen procedura e paraparë në rregullat 124 dhe 125 të Rregullores, deklarata hyrëse e ZPS-së, vijuar nga deklarata hyrëse e mbrojtëses së viktimave, në përputhje me rregullën 126 të Rregullores.

18. Në lidhje me gjatësinë e deklaratave hyrëse që do të bëhen në seancë publike, Trupi Gjykses vendos që për deklaratat hyrëse, ZPS-së t'i miratojë tri (3) orë, kurse mbrojtëses së viktimave një orë e gjysmë (1.5), sikurse është kërkuar. ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave lejohen të përdorin materiale vizuale ndihmëse si dhe materiale të tjera gjatë deklaratave hyrëse të tyre, të cilat u komunikohen Njësisë së Administrimit të Gjykatës, Mbrojtjes dhe Trupit Gjykses sa më herët që të jetë e mundur dhe jo më vonë se shtatë (7) ditë para hapjes së çështjes për gjykim. Kundërshtimet në lidhje me cilitdo material vizual ndihmës apo material tjetër të ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave, duhet të parashtrihen me shkrim jo më vonë se pesë (5) ditë para hapjes së çështjes për gjykim.

19. Në varësi të rregullës 130 të Rregullores, Trupi Gjykses do t'i japë Mbrojtjes udhëzime në lidhje me deklaratën hyrëse sipas rregullës 126(2) të Rregullores, në një fazë të mëvonshme.

20. Pas përfundimit të deklaratave hyrëse të ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme të vijohet me dëgjimin e dëshmisë së dy dëshmitarëve të parë të ZPS-së, midis të hënës, 20 shtator 2021, dhe të martës, 28 shtator 2021. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses i kërkon ZPS-së që deri të enjten, 15 korrik 2021, të dorëzojë renditjen e dëshmive të dëshmitarëve të ZPS-së për muajt

⁴⁰ E enjtja, 16 shtator 2021, do të përdoret si ditë për seancë gjyqësore vetëm në rast se procedura e paraparë në rregullat 124-125 të Rregullores dhe deklaratat hyrëse të ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave nuk arrijnë të përfundojnë më herët.

shtator dhe tetor, së bashku me informacion nëse ata do të dëshmojnë drejtpërdrejtë ose përmes videolidhjes dhe kohëzgjatjen e propozuar të pyetjeve për çdo dëshmitar veç e veç.⁴¹ Në qoftë se renditja e dëshmimeve të dëshmitarëve të ZPS-së do të ndryshojë gjatë gjykimit, për çdo ndryshim të tillë ZPS-ja duhet ta informojë menjëherë Trupin Gjykses, Mbrojtjen dhe mbrojtësen e viktimave.

E. PIKA TË TJERA

21. Duke mbajtur parasysh natyrën e pjesës së parashtrimeve në shtojcën 2 të "Parashtrimeve të Prokurorisë në përputhje me KSC-BC-2020-05/F00123" (F00130/A02) ("shtojca 2), përkatësisht pikat a-d, në pajtim me rregullën 82(5) të Rregullores Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që të dorëzojë për protokollim një version konfidencial të redaktuar të shtojcës 2, i cili do t'u jepet Mbrojtjes dhe mbrojtëses së viktimave, ose të paraqesë parashtrime për arsyet pse shtojca 2 ((pikat a-d) duhet të vazhdojë të mbajë klasifikimin rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

IV. VENDIM

22. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen që deri të **mërkurën, 30 qershor 2021**, të dorëzojnë bashkërisht dhe/ose veç e veç parashtrimet e tyre, ku t'i kërkojnë Trupit Gjykses të bëjë konstatim gjyqësor në lidhje me cilindo fakt të shqyrtuar në procese të tjera;

⁴¹ Trupi Gjykses thekson se ZPS-ja ka dhënë kohëzgjatjen e propozuar të pyetjeve të palës thirrëse në listën e vet të dëshmitarëve, f. 2-3.

- b. **URDHËRON** ZPS-në që deri të **mërkurën, 30 qershor 2021**, të parashtrojë kërkesë për ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe listës së provave sipas rregullës 118(2) të Rregullores;
- c. **URDHËRON** ZPS-në, Mbrojtjen dhe mbrojtësen e viktimave që deri të **enjten, 15 korrik 2021**, të parashtrojnë kërkesat e mundshme të tyre, sikurse përcaktohet në paragrafin 12 të këtij vendimi;
- d. **VENDOS** që në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, të zgjasë afatin për parashtrimin e përgjigjeve ndaj kërkesave sipas pikës (c) më lart, nëse do të ketë, deri të **enjten, 19 gusht 2021**;
- e. **URDHËRON** ZPS-në dhe mbrojtësen e viktimave që deri të **mërkurën, 7 korrik 2021**, t'i raportojnë Trupit Gjykues për ecurinë e diskutimeve midis tyre të përmendura në paragrafët 14 dhe 16 të këtij vendimi;
- f. **VENDOS** që në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, të shtyjë afatin e paraparë në rregullën 118(3) të Rregullores dhe **VENDOS** që gjykimi të fillojë të **mërkurën, më 15 shtator 2021**, dhe të **enjten, më 16 shtator 2021** (si datë rezervë), duke ndjekur procedurën e përkthuar në rregullat 124 dhe 125 të Rregullores, vijuar prej deklaratave hyrëse të ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave, sipas kësaj renditjeje;
- g. **VENDOS** që ZPS-ja të ketë tri (3) orë për deklaratën hyrëse të saj, e cila duhet të bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 18 të këtij vendimi;
- h. **VENDOS** që mbrojtësja e viktimave të ketë një orë e gjysmë (1.5) për deklaratën hyrëse të saj, e cila duhet të bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 18 të këtij vendimi;
- i. **VENDOS** të dëgjojë dëshmitë e dy dëshmitarëve të parë të ZPS-së midis të hënës, 20 shtator 2021, dhe të martës, 28 shtator 2021;

- j. **URDHËRON** ZPS-në që deri të **enjten, 15 korrik 2021**, të dorëzojë renditjen e dëshmimeve të dëshmitarëve të ZPS-së, sikurse përcaktohet në paragrafin 20 të këtij vendimi; dhe
- k. **URDHËRON** ZPS-në që deri të **mërkurën, 30 qershor 2021**, të dorëzojë një version të redaktuar konfidencial të shtojcës 2 të “Parashtrimeve të Prokurorisë në përputhje me KSC-BC-2020-05/F00123” (F00130/A02), i cili do t’u jepet Mbrojtjes dhe mbrojtëses së viktimave, ose të paraqesë parashtrime për arsyet pse shtojca duhet të vazhdojë të mbajë klasifikimin rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, në përputhje me paragrafin 21 të këtij vendimi.

/nënshkrim/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrim/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrim/

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 18 qershor 2021

Në Hagë, Holandë.